



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK
P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

**“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT ME SIPËRFAQE
89.4 M2 NDËRTESE NDODHUR MBI PASURINË 1/930 ZK 8561, NË ISH PARKU
AUTOMOBILISTIK KORÇË”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe D.P.K.ZH.T bazuar në dispozitat eneneve 54 gërma e) e ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM-në nr.926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” i ndryshuar; bazuar në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës”:

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Të japë pëlqimin për privatizimin e objektit me nr.pasurie 1/930 ZK 8561 me sipërfaqe 89.4 m2 ndërtesë me vendndodhje në Ish Parku Automobilistik Korçë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe D.P.K.ZH.T për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

Eva NAÇI

Ana VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____